



Datë: 21.08.2025
Numër Protokolli : 5647/2025

A.nr.1351/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani dhe anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësi të procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1351/2025, të datës 11.07.2025, të parashtruar nga ankuesja, R.G, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Gëzim Plakaj nga Drenasi, kundër organit të punësimit/Komunës së Drenasit, në çështjen juridike “*Shkelje e të drejtës në pagë*” në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.1351/2025, e datës 11.07.2025, e parashtruar nga ankuesja R.G.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, R.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), e punësuar në Komunën e Drenasit, më datë 11.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për kategorizimin e pozitës së saj të punës nga kategoria Profesional 3 në kategorinë Profesional 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 16.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Drenasit, ndërsa kjo e fundit, më datë 18.07.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, konstatoi se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja është e punësuar në Komunën e Drenasit dhe se e njëjta sipas Akt të Emërimit me numër 120-8024, të datës 06.06.2012, mban pozitën e pozitën e punës “Zyrtar për Furnizim”, në kuadër Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Drenasit.

Më tej, nga shkresat e lëndës, rrjedhë se ankuesja pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është duke realizuar pagën sipas klasës “Profesional 3” me koeficient 3.94.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së pozita e saj duhet të klasifikohet në kategorinë në Profesional 2 në pajtim me Rregulloren për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimi Civil.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: ”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Drenasit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankuses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit në këtë rast Drenasit, nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesja, për kategorizimin e pozitës së saj sipas kategorisë Profesional 2, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim

meritor. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës së theksuar më lart, ankueses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1351/2025, datë 21/08/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses R.G;
- Komunës së Drenasit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.